

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 4456/1, datë 24.8.2015

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 8.2.2013, “PËR TARIFAT DHE PAGESAT E SHËRBIMEVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 2, datë 8.2.2013, “Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, bëhet një shtesë dhe një ndryshim si më poshtë:

1. Pas pikës 10.2 shtohet pika 10.3 me këtë përmbajtje:

“10.3 Për kalimatësat:

- Personi fizik ose juridik paguan shpenzimet e transportit që llogariten nga produkti i distancës DPM - vendndodhje e kalimatësit në km me koston 24 lekë/km”.

2. Në pasqyrën 4, “Pagesa për kalibrim të instrumenteve matëse nga laboratorët e DPM-së, pika 4, “Instrumente matëse elektrike”, paragrafi “Kontatorë të energjisë elektrike shumëfazorë, me klasë saktësie 0.5 e më të mirë, 1, 2, 3” dhe paragrafi, “Njehsor elektrik të klasës së saktësisë 0.5 e më të mirë, 1, 2, 3”, riformulohen si më poshtë:

Nr.	Emërtesa	Tarifa (në lekë)
	Kontatorë të energjisë elektrike shumëfazorë, me klasë saktësie 0.5 e më të mirë, njëtariforë dhe për veprim njëkahorë	12 500

- Për kontatorë me pajisje 2- apo më shumëtariforë, për çdo shtesë pajisje, tarifore çmimi shtohet me 20% të çmimit bazë 12 500 lekë.

- Për kontatorë që punojnë me dy drejtime, marrjeje dhe dhënie energjie për çdo drejtim shtesë, tarifa rritet me 20% të tarifës bazë 12 500 lekë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Arben Ahmetaj

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani